



Funksionet dhe detyrat e BMP

Për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë, krijohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike, me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur. Bordi ka këto të drejta dhe detyra:

- a) harton rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat i paraqiten për miratim autoriteteve të parashikuara në këtë ligj;
- b) mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
- c) miraton formatin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Komiteti i Regjistrimit, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjister;
- ç) miraton kodin e etikës të audituesve ligjorë e të shoqërive audituese, të përgatitur dhe të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe mbikëqyr zbatimin e standardeve të këtij kodi;
- d) mbikëqyr kontrollin e cilësisë, që realizohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- dh) mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë
- e) miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
- ë) kur e gjykon të nevojshme, kryen investigime shtesë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- f) shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
 - g) miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të tij;
 - gj) shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;
 - h) shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në këtë ligj, që janë brenda objektit të veprimtarisë së tij.
2. Bordi miraton statutet e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre.